




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa:rr."Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail:zip_gjilan@hotmail.com,tel.0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Procesverbal

Nga Seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Gjilanit, mbajtur më 6.12.2011 me këtë:

REND PUNE

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të Kuvendit,
2. Ridestinimi i mjeteve financiare,
3. Rishqyrtimi i vendimit për qasjen e plotësimit të Planit Rregullues Urban "FIDANISHTË", 01.Nr.7083 i datës 30.05.2011,
4. Rishqyrtimi i vendimit për ofrimin e shërbimeve me pagesën e faturave për ujë dhe mbeturina,
5. Rregullorja e iniciuar nga Bashkësia Islame e Kosovës,
6. Informatë nga Kryetari i Komunës në lidhje me projektet e partneritetit publik-privat në komunë,
7. Rishqyrtimi i vendimit për lejimin e ndërrimit-kompensimit të pronës së paluajtshme, **01.Nr.7833** i datës 14.07.2009 (Velekinçë),
8. Informatë nga Drejtoria për urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në lidhje me një kontest në rrugën e Prishtinës,
9. Informatë nga komisioni për ankesa në Drejtorinë për Arsim,
10. Komunikimi zyrtarë i drejtorive komunale me Grupet politike në kuvend,
11. Informatë nga KEK-u rreth gjendjes energjetike në komunës.

Seanca filloi punimet në ora 10.10 min

Kryesuesi i Seancës

- Izmi Zeka

Në punimet e kësaj Seance të jashtëzakonshme morën pjesë:

- Anëtarët e Kuvendit
- Drejtorët e Drejtorive
- Kryetari i Komunës
- Përfaqësuesit e MPL-së
- Përfaqësuesit e OSB-së
- Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut
- Përfaqësuesit e Bashkësisë Islame
- Mediet

Seancën e jashtëzakonshme e hapi dhe udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit, z. Izmi Zeka i cili fillimisht i përshëndeti të gjithë të pranishmit në sallë.

Në vijim të fjalës së tij kryesuesi theksoi se kjo seancë e jashtëzakonshme është thirrur me kërkesë të opozitës, por po theksoj se disa pika nuk i përkasin seancës së jashtëzakonshme, sepse ka pasur mundësi që të shqyrtohen në seancë të rregullt, mirëpo ne këtë e kemi bërë për hir të transparencës dhe tolerancës të cilën e kemi gjatë punës sonë. Mirëpo herëve të tjera duhet t' i fusim çështjet që me të vërtetë janë emergjente dhe kërkojnë debat më të gjerë dhe kërkojnë një sqarim, por herëve të tjera duhet t' i fusim çështjet të cilat janë emergjente dhe kërkojnë debat më të shpejtë.

Sa i përket rendit të punës kërkoj që një pikë të hiqet nga rendi i punës e ajo është pika 5 e rendit të punës: rregullorja e iniciuar nga Bashkësia Islame, sepse kjo rregullore duhet t' i nënshtrohet komisionit për akte normative dhe statutare, Zyrës ligjore, debatit publik dhe në seancën e dhjetorit pasi t' i kalojë këto procedura e propozojmë për Kuvend. Ne me këtë jemi dakorduar edhe me kryetarin e BI-së, prandaj kërkoj që kjo pikë të shtyhet për seancën tjetër.

Arben Mehmeti- e përshëndes kryetarin e BI-së, por sa i përket asaj që e tha kryesuesi, se nuk është mirë të kthehen këto pika para afatit gjashtë mujor, është mirë të specifikohen më herët dhe t' i drejtoheni anëtarëve të Kuvendit se me cilin ligj dhe me cilin nen është i parashikuar ky obligim?

Izmi Zeka- është shumë e qartë se për një çështje brenda 6 muajve nuk mund të debatohet dy herë në Kuvend, por për hir të transparencës dhe tolerancës që e kemi në kësaj herë e kemi propozuar.

Arben Mehmeti- unë po e them se për një çështje ne kemi vendos në mënyrë të kundërligjshme dhe ju jeni kryesori që e keni lejuar këtë dhe nuk është mirë për ta akuzuar dike tjetër!

Sa i përket rendit të ditës nuk po më pëlqen kjo qasja që një propozim- rregullore me shumë interes për qytetarët e Gjilanit të mos rishqyrtohet me një arsye se ka implikime financiare dhe duhet komisioni për akte normative të merret me këtë çështje etj.

Sa kam informacione unë kjo rregullore është aprovuar në disa komuna, prandaj unë mendoj se Komuna e Gjilanit nuk është në atë gjendje që për 150-200 mijë euro të mos e miratojë një rregullore të tillë.

Unë jam për atë që të debatohet kjo çështje dhe të autorizohet kryetari Komunës për ta nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi me BI-në.

Nuk jam për ta heq nga rendi i punës, sepse kështu ia bëjmë një injorim edhe BI-së!

Kërkoj që kjo çështje t' i mbetet kryetarit të Komunës

Izmi Zeka- nuk ka nevojë për marketing. Rregullorja është për interes të qytetarëve të Gjilanit, nuk është vetëm për BI-në. Unë po e them se kjo rregullore duhet t' i kalojë procedurat, sepse kjo është obligim. Në seancën e dhjetorit, kjo rregullore pasi t' i kalojë procedurat vjen këtu dhe e kalojmë. Ne nuk jemi për ta stopuar këtë çështje dhe kemi qenë edhe më herët për ta aprovuar një rregullore të tillë.

Unë jam që kjo pikë e rendit të punës të hiqet sot nga debati me pajtim të gjithëve.

Arben Mehmeti- nuk është qëllimi këtu për marketing, por ne kemi të drejtën tonë për deklaram, prandaj unë mendoj se ka koncenzues lidhur me këtë rregullore dhe mendoj se nuk ka nevojë të kalojë nëpër shumë procedura që po i kërkon. Në momentin që në këtë Kuvend aprovet, ne po pajtohemi për ta autorizuar kryetarin e Komunës sikur që kanë vepruar komunat e tjera.

Izmi Zeka- unë kërkoj që të konstatohet prezenca e anëtarëve të kuvendit nga sekretaria, sepse nuk e kam në plan për ta autorizuar askënd për këtë rregullore, por do t' i respektoj procedurat.

U konstatua nga sekretaria se në punimet e seancës së jashtëzakonshme ishin prezent 39 anëtarë të Kuvendit, kurse dy munguan: Tefik Ibrahimimi dhe Mimoza Kadriu

Izmi Zeka- pasi që kishte kuorum për të vazhduar me punë, kryesuesi propozoi që të hiqet nga rendi i punës pika 5: Rregullorja e iniciuar nga Bashkësia Islame e Kosovës

Me 25 vota për dhe 15 kundër u miratua propozimi që pika 5 e rendit të punës: Rregullorja e iniciuar nga Bashkësia Islame e Kosovës të hiqet nga rendi i punës

Elisah Ymeri- unë iu përshëndes, por mua në këtë seancë më vije keq për atë se në çfarë niveli kemi ra! E lus komitetin për Politikë dhe Financa që të jetë pak më korrekt, sepse e kuptoj se kjo seancë është thirr për plotësim të apetiteve të opozitës, por këtu përveç pikës së dytë asnjë pikë nuk është e jashtëzakonshme dhe nuk e di pse këtu ka hyrë pika: informatë nga KEK-u.

Ju lus që herëve të tjera të keni përsysh nivelin profesional të propozimit të rendit të punës për seanca të tilla.

2. Ridestিনি i mjeteve financiare

Nuhi Nuhiu- këtu i kemi dy propozime për ridestini të mjeteve të cilat nuk kemi pasur mundësi t' i shpenzojmë për shkak të procedurave dhe kushteve të cilat i kemi pasur në kohë të fundit. Ne si qeveri komunale kemi menduar se më mirë është që këto mjete t' i ridestinojmë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e që janë 220 mijë euro, të barten në Zyren e kryetarit, mirëpo janë edhe 227.548 euro të cilat kanë qenë të destinuara për rregullin e shtratis të lumit të qytetit të cilat mjete kemi menduar që t' i ridestinojmë në Zyre të kryetari për investime të cilat janë propozuar për komunitetin.

Për shpenzim të këtyre mjeteve afatin e kemi deri më 25 dhjetor 2011, sepse nëse nuk e bëjmë ridestinin këto mjete shkojnë në suficit dhe nuk kthehen më në buxhet të Komunës.

Izmi Zeka – është momenti i fundit për t' u bërë ky ridestini dhe është mirë që të aprovet!

Zijani Maliqi- z. Maliqi kërkoi sqarim, sepse vendimi i parë ka të bëjë me mjete të Ministrisë për Planifikim dhe Ambient, kurse ridestininin e bën Komuna, prandaj nuk e kam të qartë sa ka të drejtë Komuna ta bëjë këtë ridestini të mjeteve të huaja ?

Te vendimi i dytë, mjetet janë të Komunës dhe prapë barten në Komunë, por për projekte të tjera dhe nuk ka problem, por nuk e kam të qartë se a janë kryer obligimet ndaj investitorit të

shtratit të lumit Mirusha? Thuhet se këtij investitori Komuna i ka borxh, kurse sot po i hiqen edhe ato mjete!

Te e dyta është në rregull, por te propozim-vendimi i parë duhet shikuar mirë, sepse ato nuk janë mjete të Komunës, por janë mjete të ministrisë që i ka ndarë për një projekt të caktuar.

Unë kujtoj se Komuna nuk e ka të drejtën për ridestininim të mjeteve të huaja.

Qemajl Mustafa- së pari në fillim të këtij viti fiskal Qeveria është përcaktuar që përmes Ministrisë së Ambientit ta financojë projektin e lumit Mirusha me 350 mijë euro të cilat mjete kanë qenë jashtëzakonisht të pakta. Unë kam reaguar në kohën e duhur dhe diku nga muaji prill me insistim të kryeministrit, Komunës iu janë ndarë edhe 480 mijë euro shtesë për këtë projekt. Ato mjete shtesë për 480 mijë euro dhe ato mjete janë derdh në kodin komunal. Prej atyre mjeteve iu janë kompensuar ndonjë situatë punëkryesit dhe kanë mbetur këto 227 mijë euro, kurse prej atyre 350 mijë që kanë qenë në Ministri të Ambientit për shkak të nevojave të Qeverisë kanë bërë tkurrje në investime dhe prej 350 mijë euro sot janë 220 mijë aty, kurse 130 mijë i ka marrë Qeveria për nevoja të veta. Për këto 220 mijë euro, ministria ka kërkuar që të bëjmë kërkesë, të cilën e kam bërë para disa jave për dislokim të mjeteve prej Ministrisë së Ambientit në Komunë.

Ne po marrim vendim për të dy vendimet që t' i ridestinojmë në situatat e kryera te projektet e tjera. Nuk ka nevojë dhe pse të shkojnë këto 450 mijë euro në suficit?

Zjadin Maliqi- nuk kam asgjë tek propozim- vendimi i parë, por kam dilemë mos po gabojmë te propozim-vendimi i dytë, sepse ato nuk janë mjete tona, prandaj nuk e kam të qartë sa kemi të drejtë për t' i ridestinaur mjetet që nuk janë tonat?

Nuk pati debatues të tjerë dhe kryesuesi propozoi që të aprovohet kjo pikë e rendit të punës.

Aprovohet pika e 2 e rendit të punës: . Ridestininimi i mjeteve financiare (dy vendimet) me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit

3. Rishqyrtimi i vendimit për qasjen e plotësimit të Planit Rregullues Urban “FIDANISHTË”, 01.Nr.7083 i datës 30.05.2011,

Izmi Zeka- fjalën ia bartë shefit të grupit parlamentar të LDK-së, z. Arben Mehmeti duke kërkuar që të jenë konkretë dhe i qartë lidhur me këtë pikë të rendit të punës.

Arben Mehmeti- ne kemi qenë gjithherë konkretë, por tash e kemi një shkresë nga komisioni ndërsektorial i Qeverisë së Kosovës dhe saktësisht në këtë vendim thuhet: “se në nenin 50.2 të Ligjit për planifikimin hapësinor, nr. 2003/14 (të cilin nen z. Mehmeti e citon.

Kërkesa e LDK-së është dhe ka qenë edhe më herë, por tash e ka edhe dokumentin valid të dy ministrive për ta anuluar këtë vendim dhe kjo është kërkesë e jona e bazuar në ligjin për LVL të Republikës së Kosovës.

Bahrie Mamuti- sa i përket vendimit për hartim të qasjes për hartim të planit rregullues ne në seancën e para disa muajve e kemi arsyetuar vendimin për qasje duke u bazuar në kërkesat e qytetarëve dhe zhvillimeve që kanë ndodhur pas procesit të privatizimit të pronave dhe të gjitha çështjeve që kanë qenë të adresuar nga qytetarët.

Në momentin që është bërë kërkesa që duhet t' i qasemi, atëherë ne i kemi hyrë këtij procesi sipas procedurave. Ne qasjen e kemi bërë sipas procedurave, interesat e qytetarëve i kemi pasur parasysh dhe qasjen e kemi bërë sipas procedurave që e lejon ligji.

Pas fjalës së drejtoreshës në debat morën pjesë edhe kryesuesi i Kuvendit, z. Izmi Zeka, Arben Mehmeti, Ramiz Ramadani, Qemajl Mustafa, përsëri Arben Mehmeti .

Mirëpo pas këtyre debateve kryesuesi propozoi që të deklarohen anëtarët e Kuvendit se kush është për anulim të vendimit të pikës 3 të rendit të punës: Rishqyrtimi i vendimit për qasjen e plotësimit të Planit Rregullues Urban “FIDANISHTË”, 01.Nr.7083 i datës 30.05.2011,

Për anulim të vendimit u deklaruan 14 anëtarë të Kuvendit

Kurse për propozim të vendimit që të mbetet në fuqi ky propozim –vendim i mëparshëm i Kuvendit u deklaruan 20 anëtarë të Kuvendit, kurse 4 abstenuan.

4. Rishqyrtimi i vendimit për ofrimin e shërbimeve me pagesën e faturave për ujë dhe mbeturina

Përkitazi me këtë pikë në debat morën pjesë; Riad Rashiti, Rashit Sahiti, Sokol Haziri, dhe Arben Mehmeti.

Mirëpo pas këtyre debateve kryesuesi propozoi që anëtarët e Kuvendit të deklarohen se kush është për anulim të vendimit të mëparshëm dhe kush është që të mbetet në fuqi pika e 4 e rendit të punës: Rishqyrtimi i vendimit për ofrimin e shërbimeve me pagesën e faturave për ujë dhe mbeturina

Pas këtij propozimi anëtarët e Kuvendit votuan kështu: për anulim të vendimit ishin 17 anëtarë të Kuvendit, kurse për të mbetur në fuqi ky vendim votuan 19 anëtarë të Kuvendit.

5. Rregullorja e iniciuar nga Bashkësia Islame e Kosovës,

Kjo pikë e rendit të punës në fillim të seancës u hoq nga rendi i ditës me shumë të votave të anëtarëve të Kuvendit.

6. Informatë nga Kryetari i Komunës në lidhje me projektet e partneritetit publik-privat në Komunë,

Qemajl Mustafa- unë këtu e kam vetëm të vetmen fjali; është komplet adresë e gabuar dhe mirë është që e keni manifestuar këtë vullnet të skajshëm politik, vëllazëror e shoqëror për ta krijuar këtë rend të ditës. Për ndryshe ky Kuvend e ka deleguar të drejtën për monitorim edhe për harmonizim, për votim në procesin e ndërtimeve të dy investimet të Komiteti për Politikë dhe Financa. Pasi që ka ndodhur kështu do të duhej t' i kërkohej llogari këtij komiteti sa i përket këtyre ndërtimeve dhe jo kryetarit të Komunës.

Ai është një komision i cili është formuar me një vendim dhe prej tij mund të kërkon llogari. Ne një rregullore e kemi hartuar bashkë dhe kemi thënë se kur do të dëshironi e thirrini cilin investim të dëshironi dhe çdo gjë është e hapur, kurse unë absolutisht nuk kam se çka

të them rreth këtyre investimeve. Puna atje sipas informacioneve që i kam është duke shkruar mirë. Kemi pasur dilema për ta hap bodrumin te ai objekti te Kadastri dhe ajo na ka dal mirë. Unë fillimisht kam qenë i irrituar prej në grupi të inxhinierëve të ndërtimtarisë të cilët gjëja kanë konstatuar se nuk bën për ta hapur bodrumin, sepse ka burime të ujit etj. Ne kemi marrë qëndrimin e komiteti dhe me këmbëngulësi kemi vendos që ta hapim bodrumin, sepse është përcaktim i Urbanizmit që në atë zonë ndërtimet e larta të jenë me bodrume. Pas këtij propozimi nga ana e komitetit, bodrumi është hapur dhe çdo gjë është në rregull.

Janë mbikëqyrësit të cilët vijnë para këtij komiteti dhe ky komitet duhet të sjell informacione.

Arben Mehmeti- kjo është kërkesë e jona, sepse na mungojnë shumë informacione lidhur me këtë proces. Pavarësisht se është komiteti për ta monitoruar punën e këtyre projekteve, ne shpesh po vijmë para akteve të kryera të cilat po ndodhin në procesin administrativ, në këtë rast i kryetarit të Komunës. Këta vetëm hedhin në letra emra, organe mbikëqyrëse e që janë jashtë çdo logjike.

Organet mbikëqyrëse janë nga qeverisja komunale e të cilat janë konflikte të rënda të interesit, sepse nënkryetari i Komunës është organ përgjegjës i një komisioni dhe zyrtari tjetër. Në këto komisione janë zyrtarët komunal të cilët kanë pozita të rëndësishme brenda Komunës dhe që unë mendoj se nuk kanë kohë për t' u marrë me këtë problematikë.

Me këtë rast kemi të bëjmë me shkelje të ligjeve të cilat janë në fuqi, kurse ne kemi kërkuar ta marrim një njoftim nga kryetari i Komunës se për këto partneritete është kërkuar edhe 1% nga Ministria përkatëse e Financave, respektivisht nga njësia për PPP. Nuk e kemi informatën se Komuna e Gjilanit a e ka lejen për t' i hyrë këtij procesi ? Në objektin te Kadastri është 100% hapësira e shfrytëzuar? Duam sqarim nga urbanizmi a është në harmoni me ligjin shfrytëzimi 100% i sipërfaqes për ato objekte? Po ashtu pyetje është për kryetarin dhe drejtoreshën e Urbanizmit se këto objekte a kanë leje ndërtimore dhe të planifikimit?

Të na njoftoni neve a ka leje dhe cilën datë janë lëshuar ato leje ?

Gjithashtu na i dërgoni në adresat elektronike lejet ndërtimore ?

Në aspektin bankar a janë të rregulluara të gjitha procedura?

Ne nuk i kemi këto informacione, sepse po të ishim të informuar nuk do të ishim pajtuar që kryetari i Komitetit të Pronës është duke e ndërtuar atë objekt i cili argument është në kundërshtim me ligjet në fuqi.

Izmi Zeka – unë po e them se arti i demokracisë e ka një të mirë duhet të respektohet vendimi i shumicës, për ta respektuar ligjin. Ky PP ka kaluar në procedura prej zeros dhe mua mu kanë dukur si teprime me disa procedura teknike të cilat kanë ndodhur.

Mandej KPF është një komision për mbikëqyrje dhe i kemi të gjitha të drejtat për të ftuar seancë, për të kërkuar llogaridhënie etj.

Nuk është mirë çështjet të cilat kanë kaluar këtu t' i ridiskutojmë.

Konflikt interesi, po Ali Arfi është kryetari i komiteti, por ai pronari që e ka fituar atë objekt ai ka të drejtë ta ndërtojë me kë të dojë. Ky është nënkontraktor.

Po e përsëris edhe njëherë që ndiqni rrugët ligjore dhe nëse ne bëjmë shkelje me shumicë të votave, me vendimet që i marrim ne këtu, ne përballemi me gjyqin!

Mirëpo procesin mos e pengoni, sepse këtu është votuar dhe ka kaluar njëherë!

Qemajl Mustafa- së pari po e them se në këtë shoqëri sa më i fshehtë që je dhe sa më hajn që je aq më mirë i ke punët! Nëse arrin për ta fsheh hajninë je i pastër!

Nëse dëshiron për të dal transparent dhe deklarom se prej kujt e ke pasurinë, atëherë ta përdorin tipat si Arben Mehmeti!

Në këtë shoqëri gjithçka bën të jesh, vetëm transparent nuk bën të jesh! Nëse je transparent e pëson! Unë kam deklaruar zotëri Arben që kam marrë huazim për nevoja të larjes së kredive të mia në bankat e caktuar prej x dhe y personit dhe e kam një deklaratë financiare me emër dhe mbiemër. Asnjëherë nuk kam prejudikuar që ai x dhe y njeriu vjen dhe konkurron një ditë për ta bërë një investim në Komunë!

Çdo gjë është e hapur, çdo gjë është me letra. Atij njeriu i kam thënë se nuk ka forcë që të fut në konkurrencë nëse nuk je në rregull me dokumentacion dhe konkurrencë!

Unë jam i gatshëm jo para çfarëdo gjykate, por para çfarëdo gjyqi popullor në mes të qyteti, para hotelit “Kristal” t’ i hap të tërë dokumentacionin dhe të vijë kush të dojë t’ i shfletojë dhe kontrollojë ! I sigurt jam se humbës do të dal ai që e ka filluar atë proces!

Ka dezinformata pse një ofertues? Ashtu e thotë ligji dhe nuk e thotë ndryshe!

Nëse i mbajmë këto kritere që janë të ashpra, tash me ligj ka me qenë që së paku dy ofertues duhet të jenë të përgjegjshëm, do të bindeni se nuk do të ketë investime.

900 mijë euro garancion i ka pasur ky person, nuk i ka pasur dikush tjetër ! Është dokumentacioni aty dhe ky debat po bëhet tepër dhe në kohën jo të duhur!

Është një komision që duhet të merret me këtë punë. Nëntë kompani i kanë tërheq dokumentet, kurse një ka ofertuar dhe ka krijuar konzercium dhe ka fituar. Te tjetra tre kanë ofertuar, kurse njëri në fazën e dytë është eliminuar sepse nuk ka pasur garancion! Nuk bën ta pengojmë zhvillimin e Komunës !

Izmi Zeka – në takim me komisionin që do ta kemi së shpejti do t’ i marrim edhe informacionet shtesë.

Me këtë përfundoi debati për këtë pikë të rendit të punës

7. Rishqyrtimi i vendimit për lejimin e ndërrimit-kompensimit të pronës së paluajtshme, **01.Nr.7833** i datës 14.07.2009 (Velekincë),

Saqip Osmani – informacionin lidhur me këtë për ndërrim të pronave në emër të komisionit në mënyrë detale në përbërje prej disa faqeve e dha zyrtari për pronë në Drejtori të Kadastrit dhe Gjeodezisë, z. Saqip Osmani.

Qemajl Mustafa- së pari rasti prej rastit ndryshon plotësisht, sepse kemi kompensime në zonë rurale me tokë rurale ku nuk e pengon zhvillimin dhe nëse është bërë kjo në një kohë, kur komisioni komunal ka pasur autoritet ligjor dhe ka kaluar nëpër instanca të Kuvendit, është në rregull. Nëse nuk është bërë siç është për këtë rast, sepse unë ende nuk e kam përgjigjen a ka qenë ligji për shpronësim në fuqi apo jo në momentin kur kjo është përvejdhe dhe është kontrabanduar në Kuvend? Nëpër tavolinën time nuk ka kaluar ky propozim!

Në terren situata është e kundërt! Në terren për nga vlera është tokë pyjore dhe kullosë është e tij, por jo këtë që e ka marrë! Këtë që e ka marrë është përballë lagjes së lipovicëve në Velekicë dhe është ndërmjet lagjes dhe shkollës! Kjo është ndërtimore, kurse ajo tjetra është kullosë dhe pyjore! Për nga vlera në terren po e them, kurse se çka i flasin letrat këtij zotërisë nuk e kam të qartë!

Unë jam për atë që ajo njësia për vlerësim në Prishtinë për të dal dhe vlerësuar pronë bazuar në punët profesionale. Unë sot propozoj që KPF ose grupet politike të dalim bashkë e të shohim ku e ka pasur pronën ai zotëria dhe çka ka marrë me propozim të këtij komisioni? Ai ka fituar së paku tri herë në vlerë, nëse atje lart vlen një ari 1 mijë euro, këtu poshtë minimum vlen 3 mijë euro. Mirëpo prapë ia kanë bërë edhe një favor tjetër, ia kanë dhënë dyfishin! Do të thotë 6 herë më shumë, ose i bie 5 fish më shumë se sa që i vlen një m² e tokës atje lartë. Këta njerëz kanë qenë totalisht neglizhentë dhe të pakoncentruar ! Nuk e kam të qartë si mund të korruptohen 5 njerëz për njëherë! Këta janë 5 profesionistë dhe bukur shërbyes të mirë civil. Ky është skandali më i madh të cilin e kam përjetuar në këtë qeverisje!

Kjo flet për komplet një kontrabandë, por unë do të jem edhe vetëkritik, por në tavolinën time kurrë nuk ka ardh ky rast.

Unë e lus Kuvendin që ta zhvlerësoj qysh sot këtë vendim, sepse është vendim shumë i dëmshëm, sepse e dëmton interesin publik dhe e dëmton pronën të cilën në fakt e kemi shumë të paktë si Komunë, kurse atij pronarit i bëhet zgjidhja.

Ne duhet ta bëjmë elaboratin për shpronësim, ta dërgojmë në MEF, pastaj del njësia e bën vlerësimin, kurse ne e bëjmë propozimin apo i japim kompensim të tokave, apo i japim kompensim financiar, jo vetëm ne si Komunës, sepse aty ka hise edhe Ferizaj, Shtimja dhe Kaçaniku etj. Kjo është proces komplet i gabuar.

Unë propozoj që të zhvlerësohet ai vendim dhe e dyta i propozoj komisionit disiplinor sanksionimin më të madhin meritore të mundshëm në kuptimin sanksionues duke paraparë edhe suspendim ! Mua më vjen keq dy –tre zyrtarë janë shumë të mirë si e kanë bërë këtë lajthitje nuk e di!

Sadudin Berisha- edhe ne si grup parlamentar i LDK-së e kemi kuptuar shqetësimin e drejtë të kryetarit të Komunës në takimin e Komitetit për Politikë dhe Financa në të cilin takim jemi informuar për këtë që ka ndodhur.

Sigurisht se ky Kuvend me autoritetin e vet duhet tas shfuqizojë tërësisht vendimin e nxjerr në vitin 2009 dhe të gjitha procedurat të cilat eventualisht kanë ndikuar në ndryshimin e gjendjes para vendimit.

Se ka pasur procedura të udhëhequra në një mënyrë apo në mënyrë tjetër u tha edhe nga kryetari, mund të themi me plotë përgjegjësi se nuk ka pasur fare!

Ne kemi një vendim mbi lejimin e ndërrimit, kompensimit të pronës së paluajtshme, ku ky vendim vije pas një tërësie të procedurave paraprake e që duhet të korrespondohet me ministrinë kompetente për këtë përgjegjësi aktualisht e ka marrë pa të drejtë dhe mbi bazën e ligjit KK. Në pasuesin e tretë të këtij vendimi gjithashtu që bien në kundërshtim me masat që janë marrë nga komisioni i emëruar nga kryetari i Komunës, sipas informacionit që thotë kryetari, ky komision ka qenë i detyruar sipas pikës 2 t' i raportojë për të gjitha procedurat e ndërmarra nga ky komision kryetarin e Komunës.

Informacioni është nga dora e parë se nuk ka pasur informacion të tillë!

Në pikën e tretë (citohet kjo pikë) dhe thuhet qartë se dikush i ka futur duart në xhepat e huaj! Te epen 37 ari tokë për 70 ari, unë nuk e them se është proporcioni 1;3, por është 1;10. Ligji mbi shpronësimin, Ligji mbi eksproprijimin, shpallja e interesit publik të një hapësire nuk është bërë sipas procedurave paraprake. Vendimi është kontrabanduar!

Si është kontrabanduar këtë përgjegjësi nuk e marrim, kurse propozimi i ynë është që ky vendim duhet të shfuqizohet dhe të anulohet të gjitha procedurat e ndërmarra deri më sot.

Nuk pati debatues të tjerë dhe kryesuesi i Kuvendit propozoi që të anulohet pika e 7 e rendit të punës: Rishqyrtimi i vendimit për lejimin e ndërrimit-kompensimit të pronës së paluajtshme, **01.Nr.7833** i datës 14.07.2009 (Velekincë)

Me 38 vota të anëtarëve të Kuvendit, anulohet ; vendimi për lejimin e ndërrimit –kompensimit të pronës së paluajtshme 01. nr. 7833 i datës 14.7.2009 (Velekicë) kurse një votë ishte kundër

8. Informatë nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në lidhje me një kontest në rrugën e Prishtinës,

Bahrie Mahmuti- unë do ta kem parasysh informatën ta jap sa më të saktë dhe korrekte, unë dua ta di se për cilin projekt është fjala dhe nëse është e adresuar nga Arben Mehmeti i cili ka deklaruar se e ka adresuar një adresë zyrtare për të cilën kam qenë shumë kureshtare dhe kam hulumtuar për ta gjetur atë kërkesë që po thuhet.

Mirëpo në DUMM nuk kemi asnjë kërkesë për ndonjë përgjigje, prandaj e lus Arbenin që ta adresojë kërkesën për të marrë një përgjigje sa më konkrete.

Arben Mehmeti- unë e kam dorëzuar një kërkesë në DUMM dhe më vjen keq që nuk po e pranon drejtoresha para këtij Kuvendi dhe rastin e dini shumë mirë. Rastin e din mirë, sepse herën e kaluar e ke përmendur para këtij Kuvendi, kurse sot keni ardhur fare e pa përgatitur në këtë seancë. Është shumë joserioze, sepse edhe seancën e kaluar e kam përmend dhe drejtoresha e ka pasur këtë informatë.

Rasti ka të bëjë në rrugën e Prishtinës ku objekti i mëhershëm i të njëjtit person është punuar jashtë normave, sepse lejen e ka p+1, kurse ndërtimi është bërë p+3.

Në vijim të fjalës së tij z. Mehmeti e lexon shkresën të cilin ia kishte drejtuar DUMM.

Ky objekt është te hyrja e rrugës së Prishtinës në hyrje (murit të betonuar) dhe jam shumë i sigurt se drejtoresha e din këtë proces mjaft mirë, sepse me këtë rast janë marrë edhe polica. Është mirë që të veprohet në këtë drejtim.

Ky është një rast për të cilin banorët e lagjes na u kanë drejtuar neve, kurse ne kemi bërë një shkresë, të cilën drejtoresha duhet ta gjejë dhe të merr masa së bashku me inspeksionin.

Qemajl Mustafa- ky rast është në të hyrë në anën e majtë në dalje të Gjilanit (kuptohet në rrugën e Prishtinës). Është një rast ku komuniteti ka reaguar dhe kanë ardhur në zyrën time dhe është problematizuar. Unë kam dhënë urdhëresë për ndalim të këtij procesi dhe është ndal ai ndërtim. Gjithashtu për këtë rast kemi themeluar një komision për konstatim të gjendjes për ta parë se është dhënë apo jo me normë profesionale leja atje. Dhënia e lejes për aneks i ka dy aspekte negative, sepse nuk duhet dhënë leje atij që i ka borxh Komunës, sepse ai e ka ndërtuar 1.5 kat pa leje dhe i dytë është se 100% të trollit e ka mbuluar me ndërtim. Me këtë rast më kanë dëshpëruar 4 profesionistë në krye të të cilit ka qenë profesor Ilir Gjinolli, por i cili ka ikur nga ky komision, sepse nuk është pajtuar me nënshkrimet e këtyre 4 profesionistëve të tjerë.

Drejtoresha duhet t' ia thotë Kuvendit emrat e atyre anëtarëve të komisionit, duhet ta dijë Kuvendi kush janë ata njerëz?

Bahrie Mahmuti- kjo kërkesë nuk është në Urbanizëm, por gjatë debatit e kuptova se për çka është fjala dhe mund t' iu jap informata për rastin: anëtarë të komisionit kanë qenë – Ilir Gjinolli, Hamdi Ismajli, Fahri Shaqiri Saqip Osmani dhe Enver Biçku.

Informatën në detale, do ta merr grupi parlamentar i LDK-së në formë të shkruar se si ka ndodhur ky rast.

Qemajl Mustafa- ta sqarojmë se kjo leje tërhiqet për këtë aneks, sepse nuk funksionon.

Leja nëse është dhënë prej zyrës, është bërë gabim drastik, sepse nuk epet leja për pa e konstatuar gjendjen në terren. Komisioni disiplinor duhet të merret me këtë punë, por le të merren edhe organet e tjera.

Arben Mehmeti – është shumë jo serioze drejtoresha ta konsiderojë këtë rast si të parëndësishëm, sepse ky është rast jashtëzakonisht i rëndë, prandaj edhe unë pajtohem me kryetarin që ajo leje duhet të anulohet sa më shpejtë dhe duhet të sanksionohen zyrtarët të cilët e kanë shkelur ligjin.

Izmi Zeka – kryetari e tha se duhet të anulohet kjo leje dhe merren masat e nevojshme ndaj të gjithë shkelësve të ligjit.

9. Informatë nga komisioni për ankesa në Drejtorinë për Arsim,

Izmi Zeka- informatën e keni të plotë të shkruar, prandaj nëse keni ndonjë vërejtje urdhëroni, foltorja është e juaja!

Elisah Ymeri- unë kam vërejtje të jashtëzakonshme për këtë Komision për përzgjedhje të kuadrit arsimor, nga drejtoria apo kryetari i Komunës, gjegjësisht ai që e ka formuar.

Këtë po e them, sepse ne e dimë në Kuvend se Halim Vranovci na përcjell nëpër komisione. Ky është një njeri i cili ka diferencuar njerëz dhe gjithherë ka qenë në kundërshtim me idenë tonë, prandaj Halim Vranovci, emëron drejtorë të cilët kanë dhënë “Zajm za Serbiju” dhe e kanë ndarë shtëpinë për gjysmë për serbet e kthyer. Ai njeri e emëron po atë njeri drejtor, kurse ky njeri përsëri zgjidhet në komision (shpërblehet). Tash në këtë komision dalin plotë ankesa dhe komisioni për ankesa dhe parashtresa i kthen 7-8 të arsyeshme. Ky komision nga 5 pikë dikujt ia ka rrit numrin e pikëve pa asnjë argument dhe ia ka bërë 6 ose 7.

Unë kërkoj që edhe ndaj këtij komisioni të merren masa disiplinore për parregullsi dhe kërkoj nga kryetari i Komunës që këtë njeri mos ta sillini në Kuvend, sepse është ofendim për neve !

Shkëlqim Latifi- unë po e marrë fjalën si kryesues i Komiteti të Arsimit për faktin se këtë pikë e kemi trajtuar në seancën e kaluar të këtij komiteti.

Unë shprehu keqardhjen pse kjo pikë ka hyrë në një seancë të jashtëzakonshme, sepse fare nuk ka pas nevojë të jetë këtu, për faktin që ne kemi rekomanduar që kjo informatë të shqyrtohet në seancë të rregullt, sepse janë mundësuar të gjitha mundësitë ligjore të cilat i ka pasur komisioni i ankesave.

Unë kam kërkuar në Komitet të Arsimit nga ky komision për ta plotësuar këtë raport, sepse në këtë raport ne i kemi 42 ankesa që janë të stafit profesionale, por i kemi edhe disa ankesa të tjera të cilat komisioni ka qenë duke i shqyrtuar e të cilat kanë pasur të bëjnë me stafin administrativ, teknik, shtëpiak, roje etj.

Unë kërkoj nga kryetari i Komisionit që me një informatë plotësuese për ato ankesa se a janë shqyrtuar? Çfarë mendimi është dhënë dhe a janë respektuar rekomandimet e komisionit të ankesave. Sa i përket 42 ankesave për mua është shqetësues ky fakt, sepse ky numër është shumë i madh dhe nga kjo po shihet se komisioni ka bërë tejkalime të kritereve, kritere të cilat

me koncenues të plotë i ka rekomanduar Komiteti i Arsimit dhe ka bërë tejkalim të normativit për kuadrin arsimor.

Unë në veçanti e përshëndes punën e komisionit, sepse e ka bërë një punë të shkëlqyer dhe një punë shumë profesionale. Njëkohësisht e falënderoj edhe kryetarin e Komunës i cili ia ka dhënë bazën ligjore këtij komisioni me një vendim të veçantë. Po ashtu e përshëndes edhe drejtorin e Arsimit për ekzekutimin e 6 vendimeve të cilat i ka kthyer si vendime të aprovuara pozitive.

Gjithashtu komiteti ka kërkuar që në konkursin plotësues në dhjetor t' i përfshijë edhe rastet të cilat i ka rekomanduar edhe Komiteti i Arsimit që do të rishpallen 5 vende.

Kërkoj nga kryetari i komisionit që të na informojë edhe për ankesa të tjera.

Saranda Bllaca- ne kemi biseduar edhe në komitet, sepse jam anëtare e Komitetit të Arsimit, por nuk ka qenë prezent drejtori dhe fillimisht e përshëndes punën e këtij komisioni i cili e ka bërë një punë të mirë, por jo të lehtë.

Jemi dëshmitar se komisioni për intervistim të kandidatëve ka pasur shumë parregullsi të cilin fakt e dëshmon edhe komisioni për shqyrtim të ankesave e që disa janë kthyer si pozitive, kurse disa me rekomandime.

Së pari duhet ditur se komisioni për intervistim të kandidatëve ka qenë i kontestuar nga opozita dhe nga disa këshilltarë të pozitës, sepse përbërja e këtij komisioni ka qenë në kundërshtim me ligjin. Dy anëtarë të këtij komisioni ka qenë desh të jenë zyrtarë nga DA, gjë që nuk ka ndodhur. Kështu ky komision ka vazhduar të punojë me shumë parregullsi të cilën gjë e tregon numri i ankesave. Në shumë raste nuk e ka përfill normativin dhe ka punuar në kundërshtim me këtë normativ.

Vërejtje tjetër për këtë komision është se përfaqësimi gjinor nuk është përfillur dhe nuk është debatuar fare.

Kam pyetje për kryetarin e Komunës dhe drejtorin e Arsimit se a duhet të jap përgjegjësi ky komision dhe a duhet të ndëshkohet ky komision për intervistim të kandidatëve që ka punuar me kaq shumë parregullsi dhe i ka shkaktuar dëme materiale dhe psikike shumë kandidatëve dhe shumë familjeve të tyre.

Në fund kërkoj që ky komision në të ardhmen të formohet sipas ligjit, të jetë profesionale, të zbatojë kriteret që janë nxjerr nga ky Kuvend dhe nga Komiteti i Arsimit dhe ta përfill normativin, sepse vet fakti se ka mbi 42 ankesa flet se nuk është bërë punë e mirë dhe profesionale.

Gjithashtu në të ardhmen propozoj që intervistimi i kandidatëve të bëhet nëpër shkollë dhe jo në DA, sepse vet forma e intervistimit flet për një parregullsi ose centralizëm të pushtetit.

Arben Maliqi –së pari LDK-së dhe LDD-së iu uroj bashkimin duke i uruar suksese dhe punë të mbarë dhe më vjen mirë që opozita deri në një masë ka qenë e fortë, por tash është bërë edhe më e fortë dhe me këtë fakt është më mirë për vet qytetin e Gjilanit.

Unë e përshëndes edhe kryetarin e Komunës dhe të tjerët, por z. Elisahun e njoh si djalë të mirë, por duhet pasur kujdes që mos të flasim fjalë të rënda, sepse na përcjellin qytetarët dhe nuk është vendi këtu t' i themi ato gjëra? Ju lus të përmbahemi!

Sa i përket komisionit kemi pasur pak pakënaqësi, komisioni e ka kryer punën e vet, por më së miri tregojnë ankesat, sa ka pasur dhe është e njohur për opinion se çfarë pune ka kryer. Mirëpo unë po e di se 6 raste janë kryer pas ankesave dhe dy raste sa e di unë janë diskutabile. Unë pajtohem me kryetarin e komitetit që z. Fazliu të dalin dhe ta japin sqarim në mënyrë më koncize dhe të shkurt lidhur me punën e këtij komisioni.

Elisah Ymeri- unë nuk jam i penduar për atë çka e thash, sepse atij kur nuk i ka ardh turp për të dhënë “Zajm za Serbiju” për 4-5 vjet dhe ne e kemi dekoruar me post të drejtorit të shkollës, mua nuk më vjen turp ta them pse e keni emëruar drejtor?
Vazhdoj të jem kundër dhe do të vazhdoj të jem kundër!

Qemajl Mustafa- së pari po them se nuk ka indikacion dhe nuk ka shenja se dikush qëllimshëm ka desh për ta diskriminuar dike e për ta favorizuar dike. Nëse gjeni ju lidhje të ngushtë në mes të kandidatëve fitues dhe anëtarëve të komisionit, nëse gjeni fakt se ndonjë anëtarë i komisionit ka desh për ta favorizuar dike në dëm të tjetrit, unë jam për ta mbrojt ligjin dhe për t’i fut në instancë disiplinore edhe këta.

Unë nuk kam aso indikacione, gabimet janë të mundshme, sepse 2200 kandidatë janë paraqit dhe komisioni ka punuar për një kohë të shkurtër.

Unë asnjëherë dhe me informacionet që i kam as unë as drejtori i Arsimit nuk e kemi ngrit telefonin te asnjëri anëtarë i komisionit të parë as te i dytë për t’i thënë prononi në punë atë ose këtë kandidatë!

Komisioni i parë për mua e ka kryer punën mrekullueshëm, janë 11 ankesa dhe nëse kjo ndodh në proporcion me 2200 aplikantë nuk është shumë.

Së pari z. Shkëlqimi do të duhej të jetë vetëkritik që e ka vendos veten aty, sepse ka qenë një konflikt i rëndë i interesit, kryetari i komitetit në komision për intervistim? Anëtarët e komiteti kanë hesht atëherë edhe zonjusha Sarandë ka heshtë.

Në vazhdim të fjalsë së tij kryetari i dha edhe disa sqarime lidhur e konfliktet dhe pajtimet në mes të elitave politike duke e marrë si shembull Slloveninë.

Unë nuk i jap të drejtë Elisaut i cili shprehet skajshmërisht vrazhdë për një anëtarë të komisionit, sepse ne nuk jemi krejt të njëjtë dhe jo njësoj krejt të vlefshme me këto pjesë të këtij organizmit tonë, por ky është një organizëm.

Elisah Ymeri- këtu u përmenden demokracitë dhe elitat politike edhe ndryshimet në mes të komunizmit dhe socializmit dhe e kuptoj kryetarin se ashtu do të duhej të jetë, por specifikat në Slloveni dhe vendet tjera dallojnë shumë. Në Slloveni të vetmet nga ish republikat jugosllave nuk e ka pranuar diferencimin ideopolitik. Ata kanë pasur çka të diferencojnë, por të vetmit si elitë politike nuk e kanë pranuar diferencimin ideo-politik, kurse të tjerat republika e kanë pranuar. Do të duhej të bëhet dallimi në mes të njeriut që i ka kontribuar okupatorit dhe të tjerëve që kanë punuar në administratë e vende të tjera.

Unë po them një shembull për drejtorin e shkollës, sepse është rast specifik. Aty kanë konkurruar dy kandidatë, njëri që ka vuajtur burg, ka luftuar për lirinë e Kosovës dhe njëri që ka dhënë “Zajm za Serbiju” për ta fut atë në burg që po lufton për lirinë e popullit të vetë dhe pranohet ai që jep “zajm”. Kjo është arsyeja pse unë reagoj jo të tjerat. Ky njeri përsëri dekorohet si anëtar i komisionit, ju lus nëse vazhdoni kështu ia jepni vendimin e përhershëm për komision dhe të përfundojë kjo punë.

Duhet dalluar specifikat në Kosovë dhe në Slloveni dhe vende të tjera.

Tahir Arifi-e para po them se secili komision që do të ishte në DA për përzgjedhjen e njerëzve që duhet të punojnë në arsim nuk do ta kenë lehtë. Unë jam i bindur se secili që do të jetë aty, do të dëshironte që puna t’i dilte mirë.

Unë pajtohem që kësaj radhe nga kjo që ka sjell komisioni janë bërë shumë gabime, por përfundimisht jam shumë i bindur pasi që dy herë kam qenë në atë komision dhe çdo kush që është aty fundin do të dëshironte për ta pasur të mirë.

E dyta që po e them se një komision për intervistim të kandidatëve për pranim në drejtime dhe profesione të ndryshme asnjëherë nuk do të ketë mundësi të jetë profesional. Për këtë ligji dhe ato kriteret që i kemi bërë ne dhe duhet të shikohen që sa më mirë të përfillen ashtu si janë të shkruara. Kjo mund të bëhet, përndryshe një komision profesional është kur bëhet një komision për gjuhë shqipe një për lëndë tjetër e kështu me radhë, por kjo dot ë ishte vështirë.

Është mirë që ka qenë ky komisioni tjetër dhe i ka parë lëshimet të cilat janë bërë, por te kjo puna e këtij komisioni të dytë e kërkoj një sqarim. Te lënda e gjuhës shqipe në Gjimnaz te kandidatja e Qefsere Berisha (lexohet përgjigja e ankesës).

Në vijim të fjalës së tij z. Arifi kërkon përgjigje se cilat janë parregullsitë të cilat janë gjetur në këtë procesverbal dhe a ndikojnë këto parregullsi direkt në këtë rezultat që është paraqit në pikën 3.1.

Rashit Sahiti – fillimisht e pata bindjen se kryetari në këtë seancë do të jetë shumë subjektiv, por në fund u binda me të vërtetë kah fundi i rendit të ditës se ishte shumë i sinqertë, objektiv dhe shumë i guximshëm dhe më vjen mirë dhe tash unë i tërheq ato fjalë që i thash më herët.

Mirëpo mua po më intereson vetëm një pyetje për drejtorin e Arsimit! Z. drejtor pos këtyre intervistave që janë mbajtur dhe pranuar njerëzit , a keni pranuar në procesin edukativo-arsimor ndonjë punëtorë pa konkurs në këtë fazë?

Pyetje tjetër është lidhur me rekomandimet, vendimet e komisionit komunal të themeluar nga kryetari i Komunës a janë përfill të gjitha apo janë kthyer në mënyrë selektive nëpër vende të punës?

Unë e kam një vendim këtu që ky komision e ka kthyer njeriun në punë, por nuk është marrë parasysh dhe ai rrinë në shtëpi! Për ta ruajtur buxhetin preferoj ta zbatoni vendimin, sepse ky person përmes gjykatës i realizon të drejtat e tij dhe e dëmtoni buxhetin komunal.

Nëse e bëjmë një analizë të mirëfilltë se a ka pasur subjektivizëm, jam i bindur se ka pasur dhe jam i bindur se ka pasur dhe këtu i kam emrat, por për shkaqe kolegjiale nuk po i përmend dhe jam i bindur se ka pasur subjektivizëm edhe atë tej mase.

Saranda Bllaca- unë edhe njëherë po ia bëj një pyetje kryetari se a ka qenë përbërja e këtij komisioni në pajtueshmëri me ligjin?

Profesorit Tahir po i them se kur e ke ligjin dhe normativin, nuk ka ndonjë filozofi për të punuar drejt dhe mjaft lehtë zgjidhen këto gjëra.

Sali Fazliu- këtu u ngritën disa çështje për të cilat po iu përgjigjem. Pyetje e parë se a ka edhe raste të tjera të cilat i kemi shqyrtuar dhe nuk i kemi përmend. Janë edhe 6 raste të tjera në këtë raport dhe një ka të bëjë me pozitën e sekretarit në Shkollën e Muzikës (dy ankesa për sekretar), një për mirëmbajtës, një për arkivist dhe dy për pastrues të shkollës. Këto raste janë shqyrtuar dhe i kemi kthyer përgjigje palëve.

Lidhur me pyetjen e z. Tahir po theksoj se komisioni kur i ka shqyrtuar ankesat i ka shqyrtuar vetëm në ato kërkesa që i kanë bërë palët dhe nuk është thelluar në çështje të tjera. Lutfije Avdiu është ankuar kundër zgjedhjes së kandidatës Dritë Isufi, kurse ne i kemi shqyrtuar procesverbalet e këtyre dy kandidatëve dhe kemi vërejt se procesverbali i Lutfie Avdiut është i parregullt, sepse ka pasur ndërhyrje në poentim. Për këtë kemi vendosur që të rishpallet ai vend i punës.

Bujar Nevzati- unë personalisht sot ndihem mirë, sepse që nga ardhja në pushtet e PDK-së është krijuar një hapësirë shumë më e lirë, shumë më e hapur dhe më demokratike i cili argument u pa edhe sot, sepse të gjitha pikat e rendit të punës ishin tansperente 100%.

Ashtu ishte edhe për problematikat e arsimit, por në të cilën veprimtari edhe unë kam pasur ndonjë vërejtje siç i përmendi Tahiri i cili ka qenë anëtar i këtij komisioni edhe i cili ia dinë problemet këtij komisioni.

Ka pasur mundësi që të bëhet ndonjë lëshim, por komisioni ka punuar tërë ditën, sepse ka qenë desh të intervistohen 2 mijë kandidatë dhe nga lodhja e madhe ka pasur mundësi që të bëhet edhe ndonjë lëshim.

Unë e kam thënë edhe më herët se nuk do ta nënshkruaj asnjë kontratë derisa të stabilizohet gjendja dhe të normalizohet duke u mbështetur në ligje.

Të gjitha ankesat janë shqyrtuar me përjashtim të dy ankesave të cilat komisioni i ka sjell dje, të tjerat janë shqyrtuar, punëtorët janë kthyer në vendin e punës, kurse konkursi pritet që të shpallet gjatë muajit të dhjetorit dhe ato rekomandime të cilat kanë qenë, të gjitha ato ankesa do t' i shqyrtojmë dhe vendosim sipas ligjit.

Unë po iu garantoj se po punojmë shumë më mirë, kurse këto vërejtjet e juve po i marrim parasysh dhe po marrim vendime së bashku. Iu garantoj se do të vazhdojmë për të punuar sipas ligjit në mënyrë transparente deri në fund.

Qemajl Mustafa- shumë sinqerisht po iu deklaroj se nuk e kam bërë asnjë kontakt me komisionin për ankesa. Unë e kam një vendim në fuqi i cili vendim është në frymën e asaj që biseduam sot. Nëse i dyti tenton të vijë në Shërbimin Civil në marrëdhënie pune prej një familje nuk do të pajtohem. Këtë vendim unë e kam në fuqi si kryetar i Komunës. Ky komision këtë nuk e ka marrë këtë parasysh, por unë kërkoj që kur të shpallen konkurset duhet të thuhet dhe nuk besoj që bie në kundërshtim me ligjin në rrethanat e Kosovës nëse thuhet: “për kushte afërsisht të njëjta duhet t' i epet përparësia familjeve me gjendje sociale më të ulët”. Kjo nuk është në kundërshtim me ligjin, sepse gjendja sociale te ne në Kosovë është e tillë. Ne si Kuvend duhet ta bëjmë një balancim, sepse po pyes cila është logjika të vijë i treti dhe katërti të vijë në Kuvend të punësohet dhe të mbetet një i varfër i pa punë.

Në Shkollën e Muzikës unë nuk e zbatoj një vendim të këtillë siç e thash, derisa unë të jem kryetar.

Pat pyetje se a ka punësime pa konkurs? Zëvendësimet janë pa konkurs, sepse arsimi është natyrë e tillë, nuk ka mundësi të shpallet konkurs për dy javë ose një muaj.

Leonore Bunjku – unë po theksoj se për çështje të barazisë gjinore po kalohet në heshtje dhe jam e bindur se duhet bërë më shumë zhurmë për të ardhur dhe për t' u zbatuar kjo.

Gjinia femërore shpeshherë po trajtohet si pakicë e nganjëherë ndoshta edhe si dekor. Kërkoj që tash e tutje të jeni të vëmendshëm, sepse nëse vazhdoni kështu ne nuk do të përfillim asnjë vendim nëse formohen komitete, komisione në përbërje të tillë siç janë formuar deri më tani! Jemi për barazi gjinore, por jemi edhe për vlera dhe cilësi të mirëfilltë, prandaj kërkojmë respekt e jo lëmoshë.

Izmi Zeka- znj. Leonora ka të drejtë, në të ardhmen duhet pasur parasysh këtë vërejtje.

10. Komunikimi zyrtarë i drejtorive komunale me Grupet politike në Kuvend,

Arben Dubova – unë e kërkoja fjalën për ta dhënë një sqarim për ata të cilët nuk janë informuar lidhur me një udhëzim administrativ i cili është miratuar në prill të këtij viti nga njësia e MPL-së. Ky Udhëzim e përshkruan qartë organizmin dhe funksionimin e qendrave për shërbim të qytetarëve nëpër komuna.

Unë po e theksoj vetëm nenin 10 ku thotë:” lidhur me pranimin dhe regjistrimin e kërkesave dhe parashtresave pika 1, qendrat për shërbim të qytetarëve regjistrojnë dhe protokollojnë me numër unik të gjitha kërkesat dhe parashtresat për të gjitha organet komunale, sipas njësive organizative të parapara me ligjet dhe aktet komunale në fuqi”.

Gjithashtu edhe në seancën e kaluar ka pasur disa shqetësime të këshilltarëve gjëja për mos kthyerje të përgjigjeve nga drejtoritë përkatëse ose mos trajtim të mirë të kërkesave të këshilltarëve apo grupeve politike, mirëpo sistemi i cili është krijuar në zyrat e administratës nuk lejon që kërkesat apo letrat që vijnë në drejtori të pranohen për pa u protokolluar në protokollin e Komunës.

Kjo është e rregulluar me ligj dhe çdo kërkesë e cila vjen në drejtoritë përkatëse patjetër duhet të kalojë nëpër protokoll.

Izmi Zeka – grupet politike, nëse kërkesat i bëjmë në emër të grupeve të tyre, përgjigjet t’i kthejnë drejtorët edhe nëse nuk dërgojnë në Qendrën për Shërbim me Qytetarë?

Këto janë formacione politike dhe jemi të obliguar që t’i kthejmë të gjitha përgjigjet që kërkojnë në Kuvend.

Arben Mehmeti- qëllimi i kërkesës sonë ka qenë pikërisht sqarimi i asaj që u tha nga ju si kryesues, kurse nga drejtori i Administratës u tha kinse nuk po kthen përgjigjet! Unë kam drejtuar shkresa zyrtare drejtorëve, por nga drejtori i Administratës na është kthyer shkresa, pasi është parë nga zyrtarët e Administratës dhe na është thënë se duhet drejtuar Zyrës për Qytetarë.

Unë e kama edhe Udhëzimin administrativ që e rregullon përgjegjësinë e shërbimeve me qytetarë dhe në asnjë vend nuk shkruan që zyrtarët kanë obligim për të dërguar shkresa në Zyrën për Shërbim me qytetarë. Ajo zyrë është e formuar ekskluzivisht për kërkesat e qytetarëve. Ne pse jemi opozitë edhe ne jemi institucion dhe atë e kemi krijuar dhe ne dhe e kemi krijuar atë mekanizëm për të komunikuar me qytetarët. Kjo që na tha drejtori, është absolut me çdo rregull dhe drejtorit nuk i takon për ta thënë një gjë të tillë, sepse udhëzimi administrativ i MPL e specifikon shumë mirë këtë çështje.

I falënderoj të gjitha drejtoritë të cilat kanë kthyer përgjigje, por nuk i falënderoj ata të cilët nuk kanë kthyer përgjigje.

Izmi Zeka- po e theksoj edhe njëherë se drejtorët janë të obliguar që grupeve politike t’i kthejnë përgjigje në afatin prej 7 ditëve.

11. Informatë nga KEK-u rreth gjendjes energjetike në Komunë.

Sadri Arifi- ne i kemi bërë ftesë drejtorit të KEK-ut për ta dhënë një informatë lidhur me gjendjen energjetike në Komunë, por ai ka deklaruar se nuk mund të vijë në takim, sepse ka një takim me shumë rëndësi në Prishtinë.

Mirëpo ai ka deklaruar se për gjendjen energjetike mund të jap informatë niveli qendror, sepse ajo është kompetencë e tyre.

Tahir Arifi- unë jetoj në “Q. Qeshme” dhe pjesa dërmuese e kësaj lagjeje furnizimin me rrymë që një kohë të gjatë është në raport 2;2 ose 2:3 dhe është lagjeje që askush nuk mund të më bind që pagesa diku tjetër është më e mirë se në këtë lagjeje. Kjo është e tmerrshme, por edhe më fatkeqësi është si ka mundësi të jetë gjendja 3:3 në ora 4 të mëngjesit, 12 të ditës dhe 20 të mbrëmjes. Ka revoltë dhe pakënaqësi të madhe të qytetarëve dhe nëse gjendja nuk ndryshon, unë do t’ i bashkëngjitëm qytetarëve

Arben Maliqi- unë kam vërejtje të madhe, por nuk e kam të qartë sa është kompetencë e jona. Ne jemi të vetëdijsëm se Komuna e Gjilanit është paguesja më rregullt e rrymës elektrike dhe atë jam shumë i bindur! Komunat e tjera nuk e paguajnë fare rrymën dhe kanë rrymë më shumë se ne. Kjo është një vërejtje shumë e madhe dhe kam frikë se një ditë qytetarët do ta marrin një kahe tjetër.

Lagjja e ime “Dardania” është lagjja që e paguan rrymën shumë me rregull, prandaj kërkoj që të marrim hapa të cilat janë në kompetenca tona që Komuna e Gjilanit të ketë rrymë më tepër.

Sokol Haziri- unë mendoj se kjo temë kërkon një debat më të gjerë këtu, sepse ne përfaqësojmë qytetarët e Gjilanit dhe ajo që dua të them se është përgjegjësi totale e menaxhmentit të distribucionit në Gjilan, sepse është hera e dytë që nuk i përgjigjen ftesës së KK-së për informacion. Unë e di që ata nuk kanë përgjegjësi ndaj KK-së, por e di që kanë punë me qytetarët e Gjilanit, kurse qytetarët e Gjilanit ne i përfaqësojmë. Mbi këtë bazë edhe KEK-u është i obliguar ashtu siç ka vepruar edhe Hidromorava, sepse një status kanë ato, janë kompani publike dhe u shërbejnë qytetarëve të Gjilanit, të cilët qytetarë ne i përfaqësojmë dhe ai zotëri ka pasur obligim moral, por edhe kontraktual të dal para përfaqësuesve të qytetarëve dhe t’ i drejtohet këtij Kuvendi për të treguar se çka po ndodh në Gjilan.

Këtu kemi shkelje drastike të të drejtave të njeriut, shkyçje kolektive që cenojnë të drejtat dhe liritë e qytetarëve në Gjilan.

Mbi këtë bazë unë kërkoj nga ky Kuvend që të nxjerr një qëndrim që t’ ia adresojë një shkresë Bordit të drejtorëve të KEK-ut dhe Qeverisë së Kosovës për përgjegjësinë totale të menaxhmentit të KEK-ut në Gjilan. Kjo gjithsesi duhet të ndodh, sepse me të vërtetë jemi keq. Edhe 12 vjet pas lufte të përballemi me probleme të tilla është keq, por po theksoj se nuk është e vërtetë se nuk ka rrymë !

Unë iu kisha lut z. këshilltarë dhe kryetarin e Komunës që kjo problematik të ngritet edhe në nivele të tjera aty ku është mundësia për ta ngrit!

Nuk udhëhiqen kompanitë e Gjilanit me jo gjilanas, këtë duhet ditës, sepse ai zotëria jeton në Prishtinë dhe thirret në përkatësi partiake se është herë i PDK-së, herë i AAK-së, por të keni kujdes për këta njerëz, sepse këta nuk janë të askujt!

Elisah Ymeri –edhe unë do ta ngris një shqetësim dhe po theksoj se javën e kaluar si Komitet për Zhvillim Ekonomik e kemi bërë një vizitë te dy kompani “As fude” dhe “Consoni” dhe ata me të vërtetë ishin në gjendje të mjerueshme për energji elektrike. Ata kanë deklaruar se 3;3 ose 3:4 e kanë furnizimin me energji, kurse vetëm një shkyçje atyre iu kushton jashtëzakonisht shumë. Aty përveç interesave tjera që ka Komuna, aty edhe 200-300 punëtorë marrin paga, prandaj kush të ketë mundësi ta përdorin autoritetin për t’ i furnizuar rregullisht ato dy biznese me energji elektrike! Ne do ta ngrisim si çështje këtë në Kuvend, por kësaj radhe të jetë kërkesë e imja dhe Komitetit për Zhvillim Ekonomik.

Izmi Zeka- jam i mendimit se duhet nxjerr një përfundim që të kërkojmë nga KEK-u një informatë për mënyrën dhe qasjen selektive që e ka ndaj Komunës së Gjilanit.

Qemajl Mustafa – mendoj se duhet bërë një kërkesë që menaxhmenti i KEK-ut, distribucioni në Gjilan të vijë dhe ta sjelli një informacion dhe të na informojë se çka po ndodh. Ndërsa ajo qkycja, është kritikuar nga të gjithë qytetarët në Kosovë dhe nëse është shkel e drejta e individit dhe familje është shkel me këtë ndërprerje kolektive, sepse shumica paguajnë dhe janë të rregullt.

Sa i përket bizneseve do të duhej për të intervenuar Qeveria.

Izmi Zeka- të mbetet si konkluzion që herëve tjera menaxhmenti i KEK-ut të vijë për të na dhënë informata, por edhe t’ i epet një vërejtje për mos dhënie të kësaj informate deri më tash edhe pse dy herë janë ftuar.

Sadri Arifi- t’ i përkujtoj anëtarët e KPF-së se nesër në Restorant “Bujana” mbahet një seminar për hartim të planeve të punës, prandaj është mirë të jeni të pranishëm.

Seanca i përfundoi punimet në ora 13.30 min

Procesmbajtësi

S. HASANI

Kryesuesi i Kuvendit

I. ZEKA